



BASHKIA  
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA TIRANË  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PUNËVE PUBLIKE  
DREJTORIA E PROKURIMEVE

## FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR

**Data :** 11.02.2019

**Drejtuar:** Operatorit ekonomik “Albtelecom” sh.a

**Adresa:** Tirane Kashar KASHAR Autostrada Tirane - Durres, km.7

**Procedura e prokurimit:** e zgjedhur në mbështetje të ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik” (i ndryshuar), neni 30 si dhe Neni 35/1 dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” kreu IV, Neni 33; si dhe Kreut V, Neni 45, pika 1, udhëzimit Nr 10 dt. 01.11.2017 për “Disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin Nr 6 dt. 27.01.2015” për përdorimin e marrëveshjes kuadër” (i ndryshuar), si edhe rekomandimit Nr. 13566 Prot dt 06.11.2017 nga Agjensia e Prokurimit Publik është “**Procedurë e Hapur/marrëveshje kuader**”.

**Numri i referencës së procedurës/lotit** REF-97462-12-07-2018

**Loti I:** REF-97464-12-07-2018

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **Loti I: “Shërbim për infrastrukturë të dedikuar optike dhe shërbime data”.**

**Afati kohor për kryerjen e shërbimit:** Loti I: “Shërbim për infrastrukturë të dedikuar optike dhe shërbime data”, do të jetë për një periudhë kohore 2 (dy) vjecare duke filluar nga data e lidhjes së marrëveshjes kuadër (sipas detajimit në shtojcën 11)

**Fondi limit:** 112,497,421 (njëqind e dymbëdhjetë milion e katërqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e katërqind e njëzetë e një) lekë pa tvsh i ndarë në lote si më poshtë vijon ”:

**Loti I: “Shërbim për infrastrukturë të dedikuar optike dhe shërbime data”, me fond limit 49,999,647 (dyzetë e nëntë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind e dyzetë e shtatë) lekë pa T.V.SH**

Burimi i financimit: **Vënë në dispozicion nga Buxheti i Bashkisë Tiranë sipas** Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr. 159, datë 21.12.2018 për “Miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2019-2021 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2019”

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: **03/01/2019, Ora: 11:00**

Publikime të mëparshme: Buletini i Njoftimeve Publike: **Buletini i Njoftimeve Publike Nr 50 datë 17.12.2018.**

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët **X** oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë me vlerat përkatëse të ofruara:

**1. “Abcom” sh.p.k**

**NIPT- i K11308001B**

*Vlera e Ofertës pa tvsh* = 48.450.000 (dyzetë e tetë milion e katërqind e pesëdhjetë mijë) lekë

**2. “Albtelecom” sh.a**

**NIPT- i J61824053N**

*Vlera e Ofertës pa tvsh* = 49,095,422 (dyzetë e nëntë milion e nëntëdhjetë e pesë mijë e katërqind e njëzetë e dy) lekë

**3. Bashkimi i operatorëve ekonomik “Advanced Business Solutions- ABS” sh.p.k dhe “MC Networking” sh.p.k”,**

**NIPT- i K21710002J**

**NIPT- i K72223007O**

*Vlera e Ofertës pa tvsh* = 30,999,780 (tridhjetë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e shtatëqind e tetëdhjetë) lekë

**4. “Enigma Development” sh.p.k**

**NIPT- i L62003020E**

*Vlera e Ofertës pa tvsh* = 0 (zero) lekë

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

**1. Operatori ekonomik “ABCOM” sh.p.k**

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të nenit 53 të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe Kreut VII, neni 66, pika 3 të VKM Nr.914, datë 9.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, (i ndryshuar) si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga ky operator ekonomik, nga ku

rezultoi si më poshtë:

1.1 Operatori ekonomik “ABCOM” sh.p.k sh.p.k, **nuk ka paraqitur formularin e ofertës sipas formatit të preventivit** të publikuar bashkëlidhur dokumentave të kësaj procedure prokurimi.

Për sa më sipër Operatori ekonomik “ABCOM” sh.p.k nuk plotëson një nga kërkesat bazë të një procedure prokurimi sikurse është ai i formularit të ofertës, pra “Kriteret e veçanta të kualifikimit/ pika 1/c”.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar dhe mbështetje të Kreu VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **shpall të pavlefshme këtë ofertë** pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

## **2. Bashkimi i operatorëve ekonomik “Advanced Business Solutions- ABS” sh.p.k dhe “MC Networking” sh.p.k”**

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të nenit 53 të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe Kreu VII, neni 66, pika 3 të VKM Nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, (i ndryshuar) si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga ky bashkim operatorësh ekonomik, nga ku rezultoi si më poshtë:

1. Bashkimi i operatorëve ekonomik “Advanced Business Solutions - ABS” sh.p.k dhe “MC Networking” sh.p.k, për plotësimin e “Kritereve të Veçanta të Kualifikimit/ Kapaciteti Teknik/ pika 2, pika 2.1 dhe pika 2.1.1” ka paraqitur:

- Operatori ekonomik “Advanced Business Solutions - ABS”, pjesë e bashkimit të operatorëve ekonomik ka paraqitur kontratë qeraje me operatorin “Pronet” sh.p.k, por në këtë kontratë nuk janë përcaktuar pikat ku ky operator do të marrë përsipër të ofrojë me qera infrastrukturën përkatëse.

Gjithashtu në Çertifikatën e Konfirmimit të Njoftimit të lëshuar nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare për ofrimin e shërbimit të operatorit “Pronet” sh.p.k, nuk deklarohet zona e ofrimit të rrjetit të tij.

- Operatori ekonomik “MC Networking” sh.p.k, pjesë e bashkimit të operatorëve ekonomik “Advanced Business Solutions - ABS” sh.p.k dhe “MC Networking” sh.p.k, ka paraqitur Çertifikatën e Konfirmimit të Njoftimit të lëshuar nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare për ofrimin e shërbimit, por në këtë çertifikatë nuk deklarohet zona e ofrimit të rrjetit të këtij operatori, duke mos garantuar kështu autoritetin kontraktor për ofrimin e rrjetit dhe marrjen e shërbimit përkatës në të gjitha vendndodhjet që ky operator ka marrë përsipër të mbulojë me rrjet dhe shërbim.

Bashkimi i operatorëve ekonomik “Advanced Business Solutions- ABS” sh.p.k dhe “MC Networking” sh.p.k, për këtë procedurë prokurimi ka paraqitur deklaratën “Mbi infrastrukturën e fibrave optike”. Në këtë deklaratë nuk është përcaktuar infrastruktura që zotëron secili operator pjesëmarrës i bashkimit të operatorëve ekonomik, dhe as infrastruktura e marrë me qera nga operatori “Pronet” sh.p.k.

Në vijim të arsyetimeve, autoriteti kontraktor nuk është në gjendje të gjykojë zotërimin e rrjetit nga kush dhe për cilat pika të kërkuara, pjesë e kësaj procedure.

**Për sa më sipër, bashkimi i operatorëve ekonomik “Advanced Business Solutions- ABS” sh.p.k dhe “MC Networking” sh.p.k, nuk plotëson “Kriteret e veçanta të kualifikimit/ Kapaciteti teknik/ pika 2, pika 2.1 dhe pika 2.1.1 ”.**

2. Bashkimi i operatorëve ekonomik “Advanced Business Solutions- ABS” sh.p.k dhe “MC Networking” sh.p.k, nuk plotëson “Kriteret e veçanta të kualifikimit/ Kapaciteti teknik/ pika 4 ” pasi:

- Operatori ekonomik “MC Networking” sh.p.k pjesë e këtij bashkimi, ka paraqitur kontratën për kapacitetin e kontraktuar të **IP transit** ku përcaktohet vetëm marrëveshja e **BGP** respektivisht me subjektin “Sofia Connect EOOD” dhe subjektin N.T.SH. “I.T.S” shpk, pa shërbim IP trazit por vetëm për shërbim BGP. Kontratat e paraqitura për shkëmbim protokolleesh BGP nuk garantojnë furnizim me IP transit, pra me shërbim interneti nga këto subjekte.

**Për sa më sipër, bashkimi i operatorëve ekonomik “Advanced Business Solutions- ABS” sh.p.k dhe “MC Networking” sh.p.k, nuk plotëson “Kriteret e veçanta të kualifikimit/ Kapaciteti teknik/ pika 4 ”.**

3. Operatori ekonomik “Advanced Business Solutions - ABS”, pjesë e bashkimit të operatorëve ekonomik “Advanced Business Solutions - ABS” sh.p.k dhe “MC Networking” sh.p.k, për plotësimin e “Kritereve të Veçanta të Kualifikimit/ Kapaciteti Teknik/ pika 5” ka paraqitur:

- Çertifikatën “HPE Master Accredited Solutions Expert/FlexNetwork Solutions V2” për punonjësin A.D dhe certifikatën “Comptia Security+” për punonjësin E.M , për të cilat nuk është paraqitur vërtetimi i përkthimit të këtyre certifikatave.

**Për sa më sipër, bashkimi i operatorëve ekonomik “Advanced Business Solutions- ABS” sh.p.k dhe “MC Networking” sh.p.k, nuk plotëson “Kriteret e veçanta të kualifikimit/ Kapaciteti teknik/ pika 5 ”.**

4. Bashkimi i operatorëve ekonomik “Advanced Business Solutions- ABS” sh.p.k dhe “MC Networking” sh.p.k, nuk plotëson “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit/ Kapaciteti Teknik/ pika 6”, pasi:

- Referuar *Listepagesave sipas formularit E-Sig 025/a per periudhen e kerkuar te deklaruar sipas legjislacionit ne fuqi*, të paraqitura si kriter i kërkuar i kësaj pike, bazuar në kodet profesioneve të deklaruar në këto listëpagesa / kolona 11) “*Detyra, funksioni, profesioni apo puna që ka kryer punonjësi*”, bashkimi i operatorëve ekonomik nuk plotëson numrin e kërkuar prej 30 (tridhjetë) punonjësish teknike kablli sikurse është kërkuar.

**Për sa më sipër, bashkimi i operatorëve ekonomik “Advanced Business Solutions- ABS” sh.p.k dhe “MC Networking” sh.p.k, nuk plotëson “Kriteret e veçanta të kualifikimit/ Kapaciteti teknik/ pika 6 ”.**

5. Në propozimin teknik të paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomik “Advanced Business Solutions- ABS” sh.p.k dhe “MC Networking” sh.p.k, “ZGJIDHJA E DETAJUAR TEKNIKE SIPAS SPECIFIKIMEVE TEKNIKE”, për të gjitha tabelat/ vendndodhjet e kërkuara, deklarohet se do të ofrohet shërbimi nga OE MC Networking, gjë që bie në kundërshtim me akt-marrëveshjen e bashkimit të përkohshëm të paraqitur sipas së cilës operatori ekonomik “MC Networking” , pjesë e këtij bashkimi, merr përsipër të realizojë vetëm 33% të kontratës.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 53 pika 5, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu VII, Neni 66 pika 3, e shpalli të pavlefshme këtë ofertë pasi nuk plotësonte kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

### 3. Operatori ekonomik “Enigma Development” sh.p.k

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Operatori ekonomik “Enigma Development” sh.p.k nuk ka paraqitur formularin e ofertës ekonomike, nuk përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/ kualifikimit dhe kriteret e veçanta.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 53 pika 5, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu VII, Neni 66 pika 3, **e shpalli të pavlefshme** këtë ofertë pasi nuk plotësonte kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

#### 1. “Albtelecom” sh.a

NIPT- i J61824053N

*Vlera e Ofertës pa tvsh* = 49,095,422 (dyzetë e nëntë milion e nëntëdhjetë e pesë mijë e katërqind e njëzetë e dy) lekë

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Drejtorisë së Prokurimeve, Bashkia e Tiranës, Sheshi Skënderbej, Nd. 2, Kodi postar 1001, Tirane, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë **17.01.2019**

**Ankesa:** Gjatë afatit ligjor për pritjen e ankesave nga shoqëritë pjesmarrëse në këtë procedure prokurimi në mbështetje të nenit 63 të Ligjit 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, është paraqitur ankesë pranë Autoritetit Kontraktor në lidhje me këtë procedurë prokurimi si më poshtë:

Në datën 24.01.2019, bashkimi i operatorëve ekonomik “Advanced Business Solutions- ABS” sh.p.k dhe “MC Networking” sh.p.k, ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor Bashkia Tiranë (Nr.4119 Prot), në të cilën pretendonte se vendimimi i KVO ishte i padrejtë. Me urdhër të Titullarit të Autoritetit Kontraktor nr. 4027, datë 24.01.2019 procedura e mësipërme e prokurimit u pezullua deri në shqyrtimin e plotë të saj nga Komisioni i ngarkuar për shqyrtimin e ankesës. Bazuar në relacionin e Komisionit të ngarkuar për shqyrtimin e ankesës, nr. 4119/1, datë 30.01.2019, Titullari i Autoritetit Kontraktor me vendimin nr. 4119/2, datë 30.01.2019, vendosi të mos pranojë ankesën e bashkimit të operatorëve ekonomik “Advanced Business Solutions- ABS” sh.p.k dhe “MC Networking” sh.p.k. **Më datë 30.01.2019 bashkimi i operatorëve ekonomik “Advanced Business Solutions- ABS” sh.p.k dhe “MC Networking” sh.p.k u njoh me vendimin e sipërcituar të Autoritetit Kontraktor në adresën elektronike të përcaktuar nga BOE në formularin e ankesës, si dhe në rrugë zyrtare.**